

STATUTI I SHOQËRISË

“VODO” SHPK

STATUTI
I Shoqërisë: “VODO” SHPK

Në këtë statut:

"Ligji" është Ligji Nr. 9901, Dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
"Statuti" është Statuti i Shoqërisë;

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e themelimit, emri dhe ortakët themelues

Sot më datë 01 Shkurt 2023 (dymijënjëzetëetë), është themeluar shoqëria “VODO”,
Statusi juridik: “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK).

Themeluesi i shoqërisë është Ortaku i vetëm, Lllazar A. VODO, me adresë banimi në Divjakë, me numër.
Letër Njoftimi : 037742820 dhe kartë identiteti (ID) Nr. I609170017F.

Neni 2

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria do të kryej veprimtarinë e mëposhtme:

Ndërtim i objekteve civile, industriale, turistike, bujqësore, etj. Punime gërmimi, rikonstrukcione dhe mirëmbajtje në objekte civile, industriale, bujqësore, etj.

Ndërtimi i kabanoneve bujqësore dhe blegtorale të të gjitha llojeve.

Ndërtim, dhe montim i të gjitha llojeve të serave (sera diellore, me ose pa sistem ngrohje e ftohje, me sisteme të ndryshme vaditjeje, me konstukcione metalike, plasmas ose xham, me ose pa rrjete hijezimi etj) për prodhimin e perimeve, frutave dhe fidaneve. Tregtimi dhe montimi i pajisjeve për sera bujqësore.

Furnizim, vendosje, shërbime mirëmbajtjeje për panele diellore.

Veprimtari në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe pemtarisë. Përpunimi paraprak dhe përfundimtar i produkteve të ndryshme bujqësore, blegtorale dhe frutore. Blerje shitje me shumicë a pakicë, i produkteve bujqësore, blegtorale dhe frutore. Eksport, import i produkteve bujqësore, blegtorale, frutore, lëndëve kimike e materialeve ndihmëse lidhur drejtpërdrejtë me veprimtarinë kryesore.

Import – Eksport / shitje dhe blerje të mallrave të ndryshme ushqimore industriale elektroshtëpiake, materiale ndërtimi, kancelari dhe pajisjeve industriale, makinerive, automjeteve dhe agregateve të industrisë Agro dhe Agroushqimore, si dhe çdo material tjetër të nevojshëm që lidhet me aktivitetin e shoqërisë.

Projektimi i objekteve civile, industriale të të gjitha llojeve, turistike, sportive, qendra tregtare, objekte social-kulturore, arsimore e kulturi. Projektme në fushën e ndërtimit, infrastrukturës rrugore, urbanistikës, mekanikës, ujësjellësave, gazsjellësave, kanalizime të të gjitha llojeve dhe vepra arti. Projekte teknologjike të të gjitha llojeve në fushën e industrisë si dhe projektme elektrike dhe hidraulike. Hartimi i projekteve në fushën e mbrojtjes nga zjarri si dhe hartimi, studimi dhe vlerësimi në mjedis. Projektim peisazhi, sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

Ndërtime hekurudhore e tramvaj, metrove e pistave aeroportuale, ndërtim ura dhe vepra arti, ndërtim të rrugëve, autostradave, mbikalimeve, ndërtime detare, ndërtime hidraulike e hidroteknike, vepra të veçanta e punime speciale.

Promovimi i shkëmbimeve tregtare nga Shqipëria për jashtë dhe nga jashtë për në Shqipëri.

Të tjera, raportuar vullnetarisht:. Hapje dyqane e lokale për restorante e bar bufe, hoteleri. Hapje agjensish imobiliare, detare, spedicionere, turistike, transport brenda dhe jashtë vendit (detar, tokësor dhe udhëtarësh). Hapje pika servisi dhe lavazhi.

Neni 2/1

Ushtrimi i veprimtarisë

Shoqëria ushtron veprimtarinë e vetë të përcaktuar në këtë statut në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për kryerjen e kësaj veprimtarie shoqëria mund të çelë degë, filiale dhe zyra të saj të përfaqësimit brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të vendit ku është hapur.

Shoqëria kryen veprimtarinë e saj për të realizuar fitim duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 4

Selia dhe Kontakti

Selia qendrore e shoqërisë në Shqipëri ndodhet në adresën: Rruga “Demokracia”, Nr. 15 9022, Divjakë - Fier , Lushnje.

Numër tel. Mobile : 069 644 9484

e - mail : info@vodoarchitects.com

Kreu II

Kapitali i regjistruar

Neni 5

Vlera, shlyerja dhe zotërimi i kapitalit të regjistruar

Kapitali regjistruar i shoqërisë është 1,000 (njëmijë) lekë. Shoqëria themelohet me ortak të vetëm dhe pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është :

Ortaku themelues : Llazar Agim VODO, Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1, 000 Lekë që përben 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Kontributi mund të jetë në para ose në natyrë (*pasuri të luajtshme/ të paluajtshme apo të drejta*). Ortaku/ët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para (*pika 6, neni 68 i Ligjit*).

Neni 6

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit do të fitohen apo kalohen në një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 73 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (*i ndyshuar*).

Konkretisht nëpërmjet :

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës do të hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës.

Kuotat e kapitalit të regjistruar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie në rast ndarje pasurie ndërmjet bashkëshortëve, parardhësve dhe pasardhësve.

Kalimi i kuotave në favor të një personi të tretë bëhet me miratimin e Ortakut të vetëm në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme. Në rastin e 2 (dy) më shumë ortakëve kalimi i kuotave bëhet pasi është ushtruar e drejta e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Pjesa e kuotave të fituara me dhurim nga ortaku/ët sipas pikës “ç” neni 73 i ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (*i ndryshuar*), personave të tretë mund t’i shiten duke i shlyer më parë kundërvleftën dhuruesit.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme për kalimin e kuotave, merren me vendimin e ortakëve me të drejtë vote që zotërojnë jo më pak 80 % (tetëdhjetë për qind) të vlerës nominale të kuotave të kapitalit të regjistruar.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Asambleja e Përgjithshme, mund të zmadhojë kapitalin e regjistruar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakut/ëve ekzistues në shumicën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga ortaku i vetëm në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme. Në rastin e zotërimit të kapitalit nga dy e më shumë ortakë merret me vendimin e ortakëve me të drejtë vote që zotërojnë jo më pak 80 % (tetëdhjetë për qind) të vlerës nominale të kuotave të kapitalit të regjistruar (në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit).

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë me vendimin sipas kushteve për zmadhimin e kapitalit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjeseve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9

Blerja e kuotave të veta

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t’u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja, vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 “*Kufizimet e shpërndarjeve, certifikata e aftësisë paguese*” të Ligjit dhe Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen.

Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit.

Neni 9/1

Kufizimet e shpërndarjeve, certifikata e aftësisë paguese

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Neni 9/2

Financimi i shoqërisë

Organi i Administrimit të Shoqërisë në perputhje me dispozitat në fuqi përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejtë të kërkojë nga ortaku/ët e Shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.

Financimet e mëtejshme të ortakut/ëve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varsi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde apo kontribute në natyrë.

Kreu III

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë

Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të audituesëve ligjor;
 - e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "f" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
 - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) Investime;
 - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm, i cili merr në shqyrtim të gjitha çështjet e poshtërenditura dhe vendimet i regjistron në regjistrin e posaçëm.

Kur shoqëria ka 2 (dy) e më shumë ortakë, Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose me kërkesën e ortakëve sipas përcaktimeve në Ligj dhe në Statut.

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji “Për shoqëritë Tregtare”, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret:

- a) Nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) Kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- c) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për të vendosur lidhur me çështjet e përcaktuara në Nenin 81 “Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme” të ligjit duhet të merren nga ortakët me të drejtë vote që zotërojnë Jo më pak 80 % (tetëdhjete për qind) të vlerës nominale të koutave të kapitalit të regjistruar.

Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

- a. Kryetari ose
- b. Një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortaku.

Neni 11

Votat e Ortakëve

Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

Perjashtirni nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortakut përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakut, të cilin përfaqëson.

Neni 12

Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklaratë me shkrim në selinë e shoqërisë e cila vërteton së personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

Kreu IV

Administratorët

Neni 13

Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator.

Me vendim të ortakut të vetëm, Administrator i shoqërisë “VODO” SHPK zgjidhet **Zj. Vera VODO**, me Letër njoftimi Nr. 034445528 dhe Nr. Personal (ID) G45420038K, lindur më 20.04.1964 dhe banuese në Divjakë.

Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kornbëtare të Regjistrimit.

Përcaktime ligjore lidhur me emërimin e administratorit

Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë në pajtim me parashikimet e shkronjes “c” të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të bëhen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë i marrë nga ortakët me të drejtë vote që zotërojnë jo më pak 80 % (tetëdhjetë për qind) të vlerës nominale të koutave të kapitalit të regjistruar.

Në emërimin e administratorëve zbatohen kufizimet e parashikuara në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.

Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

Administratori/ët ushtron/jnë të gjitha kompetencat e përcaktuara në nenin 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 dhe që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 81 të Ligjit.

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Në rastet e parashikuara nga pikat “3” (*...rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim...*) dhe “5” (*“...shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara” ...*), të nenit 82 të ligjit, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
4. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme.

Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
5. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.
6. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.

Nëse shoqëria emëron me shumë se një administrator, veprimet lidhur me kontratat, bankat, faturimet e shitjeve, blerje, etj, do të jenë të dakorduara me shkrim ose me postë elektronike (e-mail) sipas kompetencave që do të përcaktojnë ortaku i vetëm.

Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë. Administratori mund t’ia delegojë kompetencat e tij administratorit tjetër me shkresë ose e-mail.

Neni 15:

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratoreve

Detyra e Administratorit perfundon në rast se :

- a) I mbaron afati i emërimit të përcaktuar me vendimin e Asamblesë që e ka emëruar ose afati 5vjeçar sipas pikës 1 të nenit 95 të Ligjit ;
- b) Është shkarkuar nga Asambleja në zbatim të pikës 6 të nenit 95 të Ligjit ;
- c) Personi ndodhet në gjëndje paaftësie paguese ;
- d) Personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- e) Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë.

Neni 16

Shpërblimi, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e administratorëve

Shpërblimi i administratonit të shoqërisë do të përcaktohet nga Ortaku.

Neni 19

Procesverbalet e mbledhjeve

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

- a) Të gjitha takimeve të kryera nga Administratori; dhe
- b) Të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjeve të Administratorit, përfshirë edhe emrat e Administratorit të pranishëm në këto mbledhje.

Neni 20

Viti financiar, llogaritë vjetore, ndarja e fitimit

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht viti i parë financiar fillon në ditën e regjistrimit të shoqërisë dhe fiton personalitet juridik dhe përfundon me 31 Dhjetor të atij viti.

Pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë deklarohen sipas kërkesave ligjore.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet, operacionet e seicilit vit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori miratohen nga ortaku i vetëm në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brënda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, përdoret sipas vendimit të marrë nga ortaku i vetëm në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme dhe humbja e pësuar nga ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë përballohet nga ortaku.

Kreu V

Dividendët dhe kalimi i fitimeve në kapitalin e regjistruar

Neni 21

Dividendet

Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 “Kufizimet e shpërndarjeve, certifikata e aftësisë paguese” të Ligjit, Ortaku i vetëm në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme e Shoqërisë mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve. Në rastin e dy e më shumë ortakëve vendimi merret nga ortakët me të drejtë vote që zotërojnë jo më pak 80 % (tetëdhjete për qind) të vlerës nominale të kuotave të kapitalit të regjistruar.

Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Kreu VI

Prishja dhe njoftimet

Neni 22

Prishja dhe likuidimi

Në rastin e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (të ndryshuar).

Likuiduesi, në përputhje me ligjin dhe me vendimin të Asamblesë së Përgjithshme të marrë nga ortaku/ët që zotërojnë jo më pak se 80 % të kapitalit, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një kuotë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

Neni 23

Njoftimet

Njoftimet e kryera nga çdo person, duhet të jenë me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku.

Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, do të publikohet në QKB.

Neni 24

Parimet


Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administrator/ët.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga statuti ose nga ligji, në rrethana të njëjta, ortakët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

Neni 25

Për çështjet që nuk është shprehur Statuti, Ortaku/ët do t'i referohen përcaktimeve në Ligjin nr. 9901, Datë.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (të ndryshuar)

Ky Statut, i cili përmban edhe aktin e themelimit të shoqërisë, hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, dhe firmoset nga Ortaku themelues:



Ljazar VODO

Ortak i vetëm

